

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve M.I. dhe H.B. të dy nga ..., për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë ne bashkëkryerje nga neni 425 par. 3 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa për të akuzuarin H.B. edhe për një vepër penale përvetësim në detyrë nga neni 425 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore - DKR në Mitrovicë, dhe përgjigjeve në ankese të mbrojtësve të akuzuarve, av. V.B. dhe av. K.B., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – DKR në Mitrovicë, P.nr.121/15, të datës 24.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK, më datë 04.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore- DKR në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Mitrovicë, P.nr.121/15, i datës 24.01.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore - DKR në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.121/15, të datës 24.01.2018, të akuzuarit M.I. dhe H.B., bazuar në dispozitat e nenit 364 par.1 nën par.3 të KPPK, i ka liruar nga akuza për veprën penale përvetësimi në detyrë ne bashkëkryerje nga neni 425 par. 3 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa të akuzuarin H.B. edhe për një vepër penale përvetësim në detyrë nga neni 425 par. 1 të KPRK-së, me arsyetim se me provat e procedura në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve përmbushen elementet e veprave penale, për të cilat të akuzuarit janë akuzuar me aktakuzë. Për shpenzimet e procedurës penale është vendosur që të mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore – DKR në Mitrovicë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike , me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje ose te ndryshohet ashtu që te akuzuarit t'ia shpallë fajtor për veprat penale te propozuara ne aktakuze dhe t'iu shqiptojë dënimet konform dispozitave ligjore.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën nuk janë njoftuar fare palët pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me aktgjykim ku nuk është shqiptuar dënimi me burgim, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/I.nr.104/18, të dt. 08.03.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore- DKR në Mitrovicë, të aprovohet dhe aktgjykimi i shkallës së parë te ndryshohet, ashtu që të akuzuarit të shpallen fajtorë për veprat penale sipas propozimit në aktakuzë dhe të njëjtëve t'iu shqiptohen dënime konform dispozitave ligjore, ose të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë dhe përgjigje në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Me ankesën e paraqitur aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë, Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë drejtim, duke vepruar kështu konform dispozitave të nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit në fjalë.

Me ankesën e Prokurorisë Themelore - DKR në Mitrovicë, përkitazi me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, kontestohet mënyra se si janë vlerësuar provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë, e duke pretenduar kështu se edhe konkludimet e asaj gjykate të nxjerra në bazë të këtyre provave janë të gabuara. Pretendohet se provat në fjalë janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe të gabuara dhe se si pasojë e vlerësimit në fjalë edhe konkludimet e aprovuara kanë rezultuar me shkelje të ligjit Penal në favor të akuzuarve, për çka gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka vepruar, sidomos kur vendimin e ka marrë, duke mos marrë parasysh faktet dhe rrethanat e vërtetuara dhe atë, përveç nga deklaratat e të akuzuarve edhe nga deklaratat e dëshmitarëve por edhe provat materiale, ku rezulton gjendja faktike e konstatuar si në dispozitiv të aktakuzës, gjendje kjo faktike nga e cila plotësohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën të akuzuarit janë akuzuar me aktakuzë, mirëpo edhe përkundër gjendjes faktike të vërtetuar gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka liruar nga akuza për vepër penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 3 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa, të akuzuarin H.B. edhe për veprën penale përvetësimi në detyrë nga neni 425 par. 1 të KPK-së. Gjithashtu, gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor me pa mëdyshje është vërtetuar se i akuzuari M.I., ka qenë duke punuar depoist tek e dëmtuara, ndërsa i akuzuari tjetër H.B., zëvendës depoist, po ashtu, tek e dëmtuara dhe atë në periudhën kur kanë munguar mallrat e përshkruara më detajisht si në dispozitiv

të aktgjykimit të ankimuar dhe se duke pasur parasysh faktin se të vetmit kanë qenë që kanë poseduar çelësa të depos, atëherë, nuk ka pasur mundësi që askush tjetër të futet në depon e të dëmtuarës dhe t'i marrë gjësendet e përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktakuzës, prandaj duke marrë parasysh faktet dhe rrethanat e cekura më lartë, pa mëdyshje rezulton se vetëm të akuzuarit M.I. dhe H.B., kanë pasur qasje në depon në fjalë, prandaj, edhe është dashur që të akuzuarit të shpallen fajtorë për veprën penale përvetësimi në detyrë ne bashkëkryerje nga neni 425 par. 3 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa të akuzuarin H.B. edhe për një vepër penale përvetësim në detyrë nga neni 425 par. 1 të KPRK-së, sikur që edhe janë akuzuar me aktakuzë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të cekura si më lartë, nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor i ka vlerësuar në përputhje me dispozitat e nenit 361 të KPPK-së, kështu që drejtë i ka vlerësuar dhe analizuar faktet vendimtare, përkitazi me këtë çështje penale–juridike dhe në mënyrë të pa dyshimtë ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të së cilës edhe i ka liruar të akuzuarit nga akuza, për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë në bashkëkryerje nga neni 425 par. 3 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa për të akuzuarin H.B. edhe për një vepër tjetër penale përvetësim në detyrë nga neni 425 par. 1 të KPRK-së.

Në rastin konkret, me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë të pa kontestuar gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se i akuzuari M.I., ka punuar tek e dëmtuara në cilësinë e depoistit, ndërsa, i akuzuari i dytë H.B. zëvendës depoist dhe se përkitazi me mungesën e mallrave në depon e të dëmtuarës, të akuzuarit menjëherë pasi vërejnë mungesën e mallit të përshkruar më detajisht në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar e kanë lajmëruar krye shefin e të dëmtuarës F.H., drejtorin teknik K.I., zëvendës krye shefin S.M., shefin e mirëmbajtjes së rrjetit të kompanisë ..., ku të njëjtit menjëherë edhe e kanë lajmëruar policin, e duke ndërmarrë masë të mëtutjeshme hetimore përkitazi me këtë, pra, nga organet kompetente të udhëheqjes është formuar edhe komisioni i ndërmarrjes në fjalë, i cili edhe ka bërë regjistrimin e jashtëzakonshëm të mallrave që gjendeshin ende në depon e ndërmarrjes ..., duke konstatuar kështu, pra, gjësendet që mungojnë por edhe vlerën e tyre të përgjithshme, pra, të mallrave që mungojnë. Po ashtu, në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se depoja në fjalë ka qenë gjatë gjithë kohës e kyçur me qelës dhe se nuk është konstatuar asnjë gjurmë që do të mund të përfundohej se është bërë hapja me dhunë e depos në fjalë, pra, e vetmja mënyrë e hapjes së depos ka mbetur mundësia e keqpërdorimit të çelësit të drynit të depos. Gjithashtu, duke pasur parasysh sasinë e mallrave që kanë munguar por edhe peshën e çdo sendi veç e veç, në mënyrë të pa kontestuar është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, se të njëjtat – pra, gjësendet që kanë munguar nuk ka pasur mundësi tjetër të transportohen në forma tjera, përveç me kamion apo edhe automjet tjetër, pastaj, se duke marrë parasysh edhe faktet se çdo hyrje dhe dalje nga ndërmarrja në fjalë është bërë nën përcjelljen dhe kontrollin e rojeve – sigurimit të objektit, e vetmja mënyrë e marrjes së gjësendeve nga depoja ka qenë përmes keqpërdorimit të çelësit të drynit të depos dhe duke i bartur gjësendet në fjalë me automjet transportues të ndërmarrjes – ..., pra, me automjetin e vetë të dëmtuarës. Po ashtu, përkitazi me kohën kur ka ndodhur një gjë e tillë, nuk është vërtetuar mirëpo, në mënyrë të pakontestueshme ka rezultuar se i akuzuari M.I., pra, depoisti kryesor ka qenë në pushim vjetor dhe me tu kthyer nga pushimi vjetor ka vërejtur mungesën e gjësendeve në depo, për çka, menjëherë ka lajmëruar krye-shefin, zëvendës krye-shefin, ndërsa, këta të fundit pastaj e kanë lajmëruar policin, ku në ndërkohë edhe

është formuar edhe komisioni për regjistrimin e jashtëzakonshëm të gjësendeve në depon e të dëmtuarës.

Ndërsa, përkitazi me faktet kontestuese, se kush ishin personat që i morën gjësendet nga depoja në fjalë, gjykata e shkallës së parë, përveç deklaratës së të akuzuarve të cilët në mënyrë kategorike kanë refuzuar se i kanë marrë gjësendet në fjalë, ka dëgjuar edhe dëshmitarët, nga të cilët, përveç fakteve jo kontestuese ka vërtetuar se para se të vërehet mungesa e mallrave në depon e të dëmtuarës e të cilat më detajisht janë përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, është vërtetuar se depos në fjalë i është ndërruar dryni së bashku me qelësin dhe atë në kohën kur aty nuk ka qenë prezent fare i akuzuari M.I.-pra, depoisti kryesor dhe atë pa respektuar procedurat e parapara për ndërrimin e drynit, fakte këto dhe rrethana që janë vërtetuar nga dëshmitarët B.R., M.Sh. dhe Sh.Sh., ku nga dëshmitari Sh.Sh. - furnitor i ndërmarrjes në fjalë, është vërtetuar se në rastin konkret për tu bërë ndërrimi i drynit të depos është dashur të njoftohen organet kompetente, duke filluar nga krye-shefi e pastaj në fund për këtë të pajtohet edhe depoisti kryesor dhe pastaj blerja e drynit të bëhet përmes dëshmitarit në fjalë-furnitorit, i cili është kompetent për blerjen e gjësendeve – pra, deri në shumë prej 100 €, dhe atë përmes fakturave, pastaj, të përpilohet procesverbal për ndërrimin e drynit, gjë që, në rastin konkret dryni është blerë pa respektimin e procedurës në fjalë dhe po ashtu, pa u ditur arsyerat e ndërrimit të drynit në fjalë, për çka, pra, nuk kanë qenë të informuar përveç depoistit kryesor – të akuzuarit M.I., as vetë krye shefi i ndërmarrjes, zëvendësi i tij e as drejtori teknik, gjë që ka qenë e obliguar sipas procedurave të ndërmarrjes në fjalë. Po ashtu, faktet dhe rrethanat në fjalë i ka vërtetuar edhe dëshmitari tjetër M.Sh., vozitës pranë ndërmarrjes në fjalë, i cili ka vërtetuar se drynin, të cilin ia kanë vënë depos e ka blerë në një dyqan në qytet dhe atë në bazë të porosis së dëshmitarit tjetër B.R., i cili vetëm i ka thënë shko merre një dry në një dyqan në qytet, të cilin dëshmitari B.R. e ka porositur më parë, pastaj, të njëjtin më herët ia kanë vënë depos duke e hedhur drynin e mëparshëm, kuptohet pa e ditur se përse po bëhet një gjë e tillë dhe po ashtu pa përpiluar fare procesverbal përkitazi me këtë. Po për faktet kontestuese në këtë çështje penale-juridike, gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh edhe deklaratën e dëshmitares V.M.-auditore e brendshme e kompanisë në fjalë, e cila ka vërtetuar se depoja në fjalë nuk ka qenë e rregulluar asi soji që të mund të bëhet auditimi i rregullt i depos, pra, që i plotëson procedurat standarde të parapara për auditim, fakte këto dhe rrethana që janë vërtetuar edhe përmes ekspertizës financiare, ku konstatohet se procesi i mbajtjes së kontabilitetit nuk ka qenë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, që do të thotë se nuk janë respektuar procedurat e parapara për mirëmbajtjen e depos nga vetë menaxhmenti i ndërmarrjes, prandaj, edhe nuk është vërejtur mungesa e mallrave për të cilat ka lajmëruar i akuzuari M.I., vetëm pasi i njëjti është kthyer nga pushimi vjetor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë, gjegjësisht faktet jo kontestuese, se marrjen e mallrave në depo e ka vërejtur i akuzuari M.I., menjëherë pasi është kthyer nga pushimi vjetor, për çka, së bashku me zëvendës depoistin, pra, të akuzuarin e dytë H.B., e ka lajmëruar menjëherë krye- shefin e ndërmarrjes së bashku me zëvendësin e tij, se dryni i depos është ndërruar më herët pa njoftimin e depoistit kryesor dhe atë nga personat jo kompetent të ndërmarrjes e po ashtu, pa respektimin e procedurave të parapara nga ndërmarrja për ndërrimin e drynit të depos, pastaj, faktin se mallrat në fjalë, pra, që kanë munguar, duke pasur parasysh sasinë e tyre, peshën por edhe vetë natyrën e mallrave, nuk ka qenë e mundshme të njëjtat të merren në dorë nga depoja, pa përdorimin e ndonjë mjeti transportues të ndërmarrjes, e duke pasur parasysh edhe mënyrën e sigurimit të objektit, që e ka bërë ndërmarrja e sigurimit “Partner”

dhe faktin se me asnjë provë konkrete nuk është vërtetuar se pikërisht të akuzuarit kanë qenë personat që e kanë bërë këtë, e duke pasur parasysh edhe parimin themelore të procedurës penale “in dubio pro reo” se çdo mëdyshje për faktet themelore e pa vërtetuar duhet të interpretohet në favor të akuzuarit, atëherë, konkludimet e gjykatës së shkallës së parë, se në veprimet e të akuzuarve M.I. dhe H.B., nuk përmbushen elementet e veprave penale përvetësimi në detyrë ne bashkëkryerje nga neni 425 par. 3 lidhur me par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa për të akuzuarin H.B. edhe për një vepër penale përvetësim në detyrë nga neni 425 par. 1 të KPRK-së, janë të drejta dhe të logjikshme, që do të thotë se drejtë është aplikuar edhe Ligji Penal, dhe nuk ka shkelje të Ligjit Penal, në favor të akuzuarve, sikur që pretendohet në ankesë.

Prandaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale që me aktakuzë iu vihen në barrë, ngase përveç, pretendimeve në aktakuzë, se të akuzuarit kanë kryer veprat penale që u vihen në barrë, me asnjë provë në shkresa të lëndës por as tani me ankesë, prokuroria nuk ka ofruar prova që do të argumentonte një gjë të tillë, atëherë pretendimet ankimore të prokurorisë, se të akuzuarit është dashur të shpallen fajtorë për këto vepra penale, qartazi janë të pa bazuara e pa mbështetje në prova dhe në shkresa tjera të lëndës.

Nga çka u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.105/2018, të dt. 04.04.2018

**Procesmbajtës,
Eroll Gashi**

**Anëtarët e kolegjit,
1. Xhevdet Abazi**

**Kryetari i kolegjit,
Abdullah Ahmeti**

2. Afrim Shala
